



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

*Nr. 575 Prot  
dt. 23. 04. 2018*

**VENDIM**

Nr. 3 \_ Data 05.04.2018 \_

**Për miratimin e lejes së ujit , për përdorim uji teknologjik, lumi Vjosë, Bashkia Këlcyrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "Albanera" sh.p.k., me administrator Z. Krenar FEZGA.**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Formulari A/7 "Kërkesë për ujë për përdorim teknologjik", Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor";

**VENDOSI**

Miratimin e lejes së ujit , për përdorim uji teknologjik, lumi Vjosë, Bashkia Këlcyrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "Albanera" sh.p.k., me administrator Z. Krenar FEZGA me këto të dhëna:

Koordinatat X 44 63 429; Y 44 33 591; Z 178;  
Koordinatat e shkarkimit : X 44 63 402 Y 44 33 618 Z 166.98

Prurja mesatare; 72200 l/sek

Prurja minimale: 30000 l/sek

Sasia e ujit që do të përdoret 12 l/s

Sasia e ujit që shkarkohet 12l/s

Afati i lejes 5 vjet

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I K.B.U “VJOSË”**

**Flamur MAMAJ**

**PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”**

